



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 17.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eko DDD" për aktivitetin: "DDD i institucioneve arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3417-221 nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Eko DDD" e datës 14.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "DDD i institucioneve arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3417-221, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 12.08.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12.08.2020;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Eko DDD" me datë 14.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "DDD i institucioneve arsimore" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3417-221.

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se kontrata e menaxherit te tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates ka mangesi ju sqarojme se kontrata eshte ne rregull,afati i kontrates eshte marreveshje e tenderuesit me punetorin dhe eshte e drejte e çdo tenderuesi te beje marreveshje me cilindo profesionist qe ploteson kerkesat e kerkuara ne FDT;

-Pretendimet lidhur me faturat e paisjeve poashtu jane te pa bazuara,pasi qe eshte e drejte e secilit qe te bej marreveshje per mjete apo ti blej te njejtat nga kushdo qofte dhe se fatura eshte nje nga deshmitet e kerkuara ne FDT dhe nuk mund te kontestohet si deshmi;

-Pretendimi per referencen dhe kontraten me spiatalin "Sirona"poashtu jane te pa qendrueshme,sepse kontrtata dhe referenca jane ne harmoni me kerkesat e FDT-se;  
-Pa marre parasysh nga ku jane marre A testet per AK-ne jane valide nese kane te bejne me preparatatet e paraqitura ne oferte.

Nga sqarimet paraprake shihet qarte se AK-ja e ka bere vleresimin ne harmoni te plote me kerkesat e FDT-se dhe do te vazhdoj aktivitetin sipas Njoftimit te publikuar ne E prokurim.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

